

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7805
E enjte, 6 qershor 2024
Çmimi 0.50

Hapet Panairi i 24-të i Librit në Prishtinë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



BE-ja NË KËRKIM TË OPSIONEVE PËR DIALOGUN PAS LARGIMIT TË LAJÇAKUT

FACE 4-5



BE-ja MBËSHTET PLANIN E BIDENIT
PËR ARMËPUSHIM NË GAZA F. 2

JAVËN QË VJEN PRITET RAPORTI
PËR MASAT NDAJ KOSOVËS F. 3

LDK-ja DHE PSDHK-JA SHKOJNË
BASHKË NË ZGJEDHJE F. 6

EKONOMI



BQK-JA FORCON KORNIZËN
RREGULLATORE DHE AGJENDËN E
REFORMËS INSTITUCIONALE, SISTEMI
BANKAR MBETET I SHËNDOSHË F. 8

BILANCI I PAGESAVE NË
TREMJORIN E PARË SHËNON RRIJJE
PREJ 68.61 MILIONË EUROSH F. 8

SPORT



FBK-JA PARAQET
PËRZGJEDHËSIN E PËRFAOËSUESËS
SË KOSOVËS PËR FEMRA F. 10

Bashkimi Evropian (BE) është duke shqyrtuar edhe si t'i qaset dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por edhe kandidatët potencialë për ta ndërmjetësuar atë. Prej se është

konfirmuar se përfaqësuesi i tashëm i posaçëm i BE-së në këtë dialog, Miroslav Lajçak, është emëruar ambasador i BE-së në Zvicër, ku duhet ta nisë mandatin më 1 shtator, kanë nisur edhe

spekulimet se kush do të jetë pasardhës i tij. Sipas burimeve diplomatike të BE-së, edhe zgjedhja e pasardhësit të Lajçakut, në një mënyrë, është e lidhur me zgjedhjet evropiane që do të bëhen këtë verë

"DUAM
NDRYSHIM DHE
E DUAM TANI",
THIRRJA E
AMBIENTALISTËVE
TË RINJ NË
DITËN BOTËRORE
TË MJEDISIT F. 7



ZGJEDHJET
EVROPIANE, KURTI
U DREJTOHET
BASHKATDHETARËVE:
VOTA JUAJ DUHET TË
JETË KUNDËR
RREZIQEVE QË
E KËRCËNOJNË
UNITETIN E BE-së F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tajani: Nuk do ta miratojmë përdorimin e armëve italiane kundër Rusisë

ROMË, 5 QERSHOR - "Ne nuk do të dërgojmë ushtarë italianë për të luftuar në Ukrainë dhe nuk do ta autorizojmë përdorimin e armëve italiane për të sulmuar rusët jashtë territorit ukrainas. Ne nuk jemi në luftë me Rusinë.

Ne mbrojmë të drejtën e Ukrainës për pavarësi dhe liri", ka deklaruar ministri i Jashtëm i Italisë, Antonio Tajani. Ai ka thënë se një gjë e tillë nuk do të thotë se Italia nuk e mbështet Ukrainën. "Armët tona, duke

përfshirë armët e mbrojtjes ajrore, do të duhet të përdoren për ta mbrojtur Ukrainën brenda territorit ukrainas. Kjo nuk do të thotë se ne nuk duam ta mbështesim Ukrainën, përkundrazi. Ne jemi shumë të

vendosur për ta mbrojtur pavarësinë. Ne po punojmë shumë për përshkallëzimin e situatës. Ne po e bëjmë këtë në Ukrainë dhe, po ashtu, në Lindjen e Mesme", ka thënë Tajani.



BE-ja mbështet planin e Bidenit për armëpushim në Gaza

BRUKSEL, 5 QERSHOR - Bashkimi Evropian (BE) mbështet plotësisht planin e paraqitur nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, që do të mundësonte një armëpushim të qëndrueshëm në Gazë, lirin e të gjitha pengjeve dhe rritje të ndihmës humanitare, ka thënë kryediplomati i bllokut, Josep Borrell.

Një plan për armëpushim, i shpallur javën e kaluar nga presidenti amerikan Joe Biden, përfshin, mes të tjerash, armëpushimin e plotë, tërheqjen e forcave izraelite nga zonat e populluara në Gazë, dërgimin e ndihmave atje dhe lirin e pengjeve nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja.



"BE vlerëson përpjekjet e vendosura të ShBA-së, Egjiptit dhe Katarit për lehtësimin e negociatave për t'i dhënë fund luftës midis Izraelit dhe Hamasit,

njëkohësisht duke garantuar sigurinë e Izraelit, për të cilën BE-ja mbetet plotësisht e përkushtuar", është thënë në deklaratë.

Një ndihmës i kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu ka thënë se Izraeli e ka pranuar atë, ndonëse, sipas tij, plani ka të meta dhe do ende punë.

Hamasi ka thënë se e mirëpret nismën e presidentit Biden, por se kërkon garanci se do t'i jepet fund ofensivës në Gazë, e cila, sipas tij, ka lënë mbi 36 000 njerëz të vrarë.

"Nevojitet urgjentisht një armëpushim i qëndrueshëm, për ta siguruar mbrojtjen e civilëve, lirin e pakushtëzuar dhe të menjëhershëm të të gjitha pengjeve, siguria dhe mirëqenia e të cilëve është shqetësuese, dhe për ta rritur rrjedhën e ndihmave humanitare shumë të nevojshme në Gazë", është thënë në deklaratë.

Në fund BE-ja u ka kërkuar palëve të pranojnë dhe përmbushin propozimin trefazor duke thënë se "është e gatshme të kontribuojë në ringjalljen e një procesi politik për një paqe të qëndrueshme, të bazuar në zgjidhjen me dy shtete, dhe të mbështesë një përpjekje të koordinuar ndërkombëtare për rindërtimin e Gazës".

Hamasi e sulmoi Izraelin më 7 tetor të vitit të kaluar, duke vrarë mbi 1 200 njerëz dhe duke marrë peng rreth 250 të tjerë. Pas këtij sulmi nisi lufta në Rripin e Gazës - e kontrolluar nga Hamasi. Dhjetëra pengje të marra prej këtij grupi u liruan gjatë një armëpushimi në nëntor, ndërsa disa të tjera u gjetën - të vdekur ose të gjalla - nga trupat izraelite.

Zelensky do të takohet me Bidenin dhe Macronin gjatë qëndrimit në Francë



KIEV, 5 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, do të takohet me homologun e tij ukrainas Volodymyr Zelensky këtë javë gjatë qëndrimit në Francë, ku do të marrin pjesë në shënimin 80-vjetorit të zbarkimit të trupave aleate në Normandi gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka thënë më 4 qershor këshilltari i Sigurisë Kombëtare, Jake Sullivan. Presidenti francez Emmanuel Macron do ta presë gjithashtu presidentin ukrainas në Paris më 7 qershor, ka njoftuar Pallati Elyse. Në Normandi do të mblidhen liderët e 25 shteteve dhe qeverive, së bashku me dhjetëra veteranë të Luftës së Dytë Botërore, për t'i

nderuar gati 160 000 trupa nga Britania, Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe vendet e tjera, që zbarkuan më 6 qershor 1944. Vizita shtetërore e Bidenit do të mundësojë "bashkëpunim të ngushtë" mes Francës dhe ShBA-së për krizat botërore në prag të ngjarjeve ndërkombëtare. Ndërkohë kryeministria italiane Georgia Meloni ka thënë se Zelensky do të marrë pjesë në samitin e G7-s, grupit të shtatë ekonomive të mëdha, që do të mbahet nga 13 deri më 15 qershor në rajonin jugor italian të Pulias. Në samit do të marrë pjesë edhe presidenti Biden, njoftoi Shtëpia e Bardhë. Gjatë

ngjarjes së 13 dhe 14 qershorit në Pulia, Biden dhe udhëheqësit e G7-s do të diskutojnë "një sërë çështjesh më të ngutshme globale, duke përfshirë mbështetjen e palëkundur për Ukrainën", ka thënë zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre.

"Udhëheqësit e G7-s do të ndërmarrin hapa për ta promovuar sigurinë ekonomike dhe qëndrueshmërinë", është thënë në deklaratë. Ajo ka thënë se Bideni dhe udhëheqësit e G7-s do ta "dyfishojnë angazhimin e tyre për t'i mbështetur vendet në zhvillim që duan të investojnë në të ardhmen e tyre".

Rusia kërcënon Francën, Kremlini është i gatshëm t'i sulmojë trajnuesit ushtarakë francezë në Ukrainë

MOSKË, 6 QERSHOR - Rusia iu përgjigj me kërcënim raporteve se Franca së shpejti mund të dërgojë trajnerë për ta ndihmuar ushtrinë ukrainase. "Asnjë instruktor i përfshirë në trajnimin e ushtrisë ukrainase nuk ka imunitet. Nuk ka rëndësi nëse janë francezë apo jo", ka thënë zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, raporton "AFP".

Javën e kaluar komandanti i Ukrainës, Oleksandr Syrskyi, ka thënë se trajnerët francezë do të vinin në Ukrainë "së shpejti", një deklaratë e cila është mohuar në atë kohë si në Paris ashtu edhe në Kiev. Presidenti francez Emmanuel Macron, i cili do të takohet me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky këtë javë, gjatë 80-vjetorit shënimit të zbarkimit të

Ditës D në Francë, mund të shpallë së shpejti një koalicion të vogël vendesh të gatshme të dërgojnë trajnerë në terren në Ukrainë, raporton "Le Monde". "Nuk ka asnjë konsensus sot për dërgimin, marrjen dhe miratimin zyrtar të trupave tokësore. Por, në një situatë dinamike, asgjë nuk duhet të përjashtohet", ka thënë Macroni.



Arrestimi i shtesave të Kosovës në Serbi, DASH-i bën thirrje për proces të drejtë ligjor

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) i ka thënë të mërkurën Radios Evropa e Lirë se është në dijeni për arrestimin e një individi nga autoritetet serbe, i dyshuar për krime luftar në vitet '90, dhe bën thirrje për një proces ligjor të drejtë dhe transparent ndaj tij dhe personave të tjerë të arrestuar me dyshime të njëjta. Një zëdhënëse e DASH-it e ka dhënë këtë deklaratë, në kërkesën për ta komentuar ndalimin e shtetasit të Kosovës, Tefik Mustafa, nga autoritetet serbe, në pikëkalimin kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë, Merdar, më 1 qershor. Një gjykatë në Beograd ka marrë vendim ndaj tij për paraburgim prej 30-ditësh. "Ne u bëjmë thirrje institucioneve serbe që të garantojnë një proces ligjor të drejtë dhe transparent për këtë rast, ashtu sikurse me çdo arrestim tjetër, në përputhje me sundim të ligjit", është thënë në përgjigjen e Departamentit Amerikan të Shtetit.



Zëvendëskryeministri i Serbisë, Ivica Dačić, ka thënë më 1 qershor se Mustafa dyshohet se, në cilësinë e anëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është përmendur nëpër deklarata të dëshmitarëve si pjesëmarrës në

kidnapimin e tre zyrtarëve policorë. Ministria e Jashtme e Kosovës e ka konsideruar ndalimin e Mustafës arbitrar dhe ka kërkuar ndihmën e faktorit ndërkombëtar për lirimin e tij.

Ministria e ka vënë në dispozicion edhe numrin e telefonit për të gjithë shtetasit e Kosovës që mund të ballafaqohen me vështirësi gjatë udhëtimit të tyre nëpër Serbi. Në tre vitet e fundit në Serbi

janë arrestuar disa shtetas të Kosovës për, siç është thënë, dyshimet se kanë kryer krime gjatë luftës në Kosovë në periudhën 1998-'99. Më 17 prill të këtij viti autoritetet serbe e kanë arrestuar shtetasin tjetër të Kosovës, Sadik Duraku, për dyshime të njëjta, në njërin prej pikëkalimeve kufitare Kosovë - Serbi. Familjarët e tij i kanë hedhur poshtë akuzat, duke thënë se Duraku ka jetuar në Angli në atë periudhë, bashkë me familjen e tij. Duraku është arrestuar në një vendkalim kufitar në mes të Kroacisë dhe Serbisë dhe një gjykatë serbe ia ka caktuar masën e paraburgimit po atë muaj. Së fundmi, atij i është vazhduar masa e paraburgimit edhe për 30 ditë. Më herët gjatë vitit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar Serbinë për, siç ka thënë, arrestime të padrejta, të qëllimshme dhe dashakeqe të qytetarëve të Kosovës.

Javën që vjen pritet raporti për masat ndaj Kosovës

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, pritet që javën e ardhshme ta dorëzojë raportin për hapat që ka bërë Kosova për përmirësimin e detyrimeve për heqjen e masave të BE-së ndaj saj. Këtë e ka mësuar Radio Evropa e Lirë nga burimet diplomatike në Bruksel. Një raport të tillë nga shefi i diplomacisë së BE-së e kishin kërkuar vendet anëtare në mënyrë që të vlerësohet nëse janë pjekur kushtet që Kosovës t'i hiqen masat. Këto burime nuk dinë se çfarë saktësisht do të përmbajë raporti dhe nëse Borrelli do ta rekomandojë heqjen e masave. Qeveria e Kosovës ka insistuar disa herë se ajo i ka përmirësuar kërkesat dhe se situata në veri të Kosovës është shtensionuar, serbët e Kosovës kanë pasur mundësi të votojnë për shkarkimin e kryetarëve të komunave dhe tash, sipas tyre, nuk ka më arsye që të mbahen këto masa. Ky raport ishte planifikuar të dorëzohet më herët, sepse vendet e BE-së kishin kërkuar që kjo të bëhet "sa më parë që të jetë e mundur", por ishte shtyrë për shkak të veprimeve të autoriteteve të Kosovës për mbylljen e objekteve të Bankës Kursimore postare të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës. Më 20 maj autoritetet në Kosovë kanë kryer një operacion policor



ndaj institucioneve financiare serbe në veri të Kosovës, që ka rezultuar me mbylljen e gjashtë objekteve të Bankës Kursimore të Postës dhe Bankës Popullore të Serbisë në katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Gjatë aksionit, që autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar si masë për vendosjen "e rendit dhe ligjshmërisë", janë konfiskuar prova të ndryshme, përfshirë para. Radio Evropa e Lirë ka mësuar nga burimet diplomatike se për

shkak të zhvillimeve rreth mbylljes së objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë, është kërkuar që këto veprime të merren parasysh në raportin e Borrellit. Këto veprime të autoriteteve të Kosovës ishin quajtur si "të njëanshme dhe të pakoordinuara me potencial që të nxisin tensione". "Masat ishin vendosur si pasojë e veprimeve të pakoordinuara dhe të njëanshme të Kosovës, që sollën deri të përshkallëzimi i situatës. Masat ishin vendosur me qëllim

që të motivohen autoritetet e Kosovës për të ndërmarrë hapa për shtensionim. Natyrisht, gjithçka që ka ndikim negativ në terren, dhe në përpjekjet për shtensionim, është duke u marrë parasysh dhe është duke u përfshirë në raport", ka thënë zëdhënësi i BE-së. Kur ishte zhvilluar debati për masat ndaj Kosovës në Komitetin për Politikë dhe Siguri, ku janë diplomatët e vendeve anëtare, shumica kishin propozuar që ato masa të hiqen tërësisht, ndërsa disa shtete që

ato të hiqen gradualisht. Por, tash diplomatët presin të shohin se çfarë do të përfshihet në raportin e Borrellit në mënyrë që t'i shprehin pastaj qëndrimet e tyre. Masat ndaj Kosovës ishin vendosur para një viti si përgjigje ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës kur Kosova dërgoi në ndërtesat e komunave kryetarët shqiptarë të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët. Ndër masat e BE-së janë suspendimi i përkohshëm i punës së trupave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kosova, po ashtu, nuk ftohet në ngjarjet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale janë suspenduar, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Masat e tjera janë suspendimi i programimit të fondeve për Kosovën në kuadër të IPA 2024 (Fondet e Para-Anëtarësimit). "Propozimet e dorëzuara nga Kosova në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë paraqitur për shqyrtim në bordin e këtij fondi. Kontratat e reja ku autoritetet e Kosovës janë përfutuese tash për tash janë të ndalura. Projektet në vazhdim e sipër të BE-së nuk janë të ndikuara e as financimi i shoqërisë civile në Kosovë apo programet tejkuftare", ka sqaruar ky zëdhënësi.



BE-ja në kërkim të opsioneve për dialogun pas largimit të Lajçakut

Bashkimi Evropian (BE) është duke shqyrtuar edhe si t'i qaset dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por edhe kandidatët potencialë për ta ndërmjetësuar atë. Prej se është konfirmuar se përfaqësuesi i tashëm i posaçëm i BE-së në këtë dialog, Miroslav Lajçak, është emëruar ambasador i BE-së në Zvicër, ku duhet ta nisë mandatin më 1 shtator, kanë nisur edhe spekulimet se kush do të jetë pasardhës i tij. Sipas burimeve diplomatike të BE-së, edhe zgjedhja e pasardhësit të Lajçakut, në një mënyrë, është e lidhur me zgjedhjet evropiane që do të bëhen këtë verë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Bashkimi Evropian është duke shqyrtuar edhe si t'i qaset dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por edhe kandidatët potencialë për ta ndërmjetësuar atë. Prej se është konfirmuar se përfaqësuesi i tashëm i posaçëm i BE-së në këtë dialog, Miroslav Lajçak, është emëruar ambasador i BE-së në Zvicër, ku duhet ta nisë mandatin më 1 shtator, kanë nisur edhe spekulimet se kush do të jetë pasardhës i tij. Por, burimet diplomatike në BE thonë për Radion Evropa e Lirë se "më e rëndësishme se kush do të jetë në këtë post, është se çfarë qasjeje do të kenë BE-ja dhe strukturat e saj të reja që do të dalin pas zgjedhjeve evropiane ndaj këtij procesi".

Sipas burimeve diplomatike, edhe zgjedhja e pasardhësit të Lajçakut, në një mënyrë, është e

lidhur me zgjedhjet evropiane që do të bëhen këtë verë. Këto burime thonë se përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, nuk do të jetë ai që do ta emërojë pasardhësin e Lajçakut në postin e të dërguarit të posaçëm për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, por se kjo do t'i lihet shefit apo shefes së ardhshme të politikës së jashtme të BE-së. "Ne jemi tash në një fazë ku po qarkullojnë emra të kandidatëve potencialë për pasardhës të Lajçakut në rolin e ndërmjetësuesit në dialog. Por, do të presim që, së pari, të emërohet përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri për mandatin e ardhshëm pesëvjeçar. Pasi që ai është edhe udhëheqës i dialogut në nivel të lartë, është logjike që të ketë mundësi të vendosë se kë duhet ta emërojë në rolin e të dërguarit të posaçëm për dialog", thotë një

diplomat i BE-së.

Emërimi i përfaqësuesit të lartë është një proces që mund të zgjatet, sepse lidhet me emërimet në postet e tjera udhëheqëse të BE-së, për të cilat duhet të ketë një balancë mes grupeve partiake në BE dhe mes vendeve anëtare. Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, që do të zhvillohen nga data 6 deri më 9 qershor, udhëheqësit e vendeve anëtare do të tentojnë të merren vesh për emërimin e presidentit të Komisionit Evropian. Për këtë duhet ta kenë shumicën e kualifikuar në Këshillin Evropian. E pasi të merren vesh për këtë pozitë, duhet ta zgjedhin presidentin e Këshillit Evropian dhe përfaqësuesin e lartë.

Për këtë qëllim BE-ja do t'i mbajë dy samite - një të jashtëzakonshëm dhe joformal më 17 qershor dhe një formal më 27 dhe 28 qershor. "Synim do të jetë që e tërë paketa të dakordohet mes liderëve të vendeve anëtare para fundit të qershorit. Kjo do t'i mundësonte Parlamentit Evropian që t'i konfirmonte këto emërimet në seancën e korrikut. Përndryshe, do të duhej të kalonin në seancat e vjeshtës dhe kjo do të krijonte vonesa", thotë një diplomat i BE-së.

Nëse Ursula von der Leyen, presidentja e tashme e Komisionit Evropian, e fiton

edhe një mandat në këtë post - e ajo është favorite pasi është kandidatë e grupit më të madh politik në Parlamentin Evropian, i njohur si EPP - atëherë pritet janë që presidenti i Këshillit Evropian, si pasardhës i Charles Michelit, të jetë nga radhët e liberalëve. Pra, vetëm pasi të konfirmohet se kush do të jetë përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, do të emërohet edhe pasardhësi i Lajçakut si ndërmjetësues i dialogut Kosovë - Serbi. Kjo, në rastin më të mirë, mund të ndodhë gjatë verës.

Burimet diplomatike në BE nuk presin të ketë vakum sepse, sipas tyre, nëse pasardhësi i tij nuk do të jetë i emëruar deri në fund të gushtit, Lajçakut do t'i zgjatet mandati për disa muaj.

Në mesin e kandidatëve që janë përmendur deri tash si pasardhës të mundshëm të tij është ish-presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor. Vetë ai dhe Ministria e Jashtme e Sllovenisë kanë konfirmuar se ka interes për këtë post. Por, duket se në strukturat e BE-së është duke u kërkuar një profil tjetër i politikanit, që do ta merrte rolin për ta vazhduar ndërmjetësimin e dialogut.

Në mesin e kandidatëve potencialë, nga burimet diplomatike në BE përmenden edhe ish-ministri i Jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto, dhe diplomati danez Peter Sorensen,

të cilët kanë edhe përvojë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Burimet e BE-së thonë se kushdo që të jetë në atë post dhe pa marrë parasysh se kush do të jetë përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, do të duhet të insistojë në zbatimin e të gjitha marrëveshjeve që Kosova dhe Serbia kanë arritur deri më tash në dialog.

Ky, në fakt, ka qenë vazhdimisht edhe qëndrim i vendeve anëtare të BE-së, edhe i partnerëve ndërkombëtarë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe.

Burimet nuk mohojnë se ka një dozë zhgënjimi me mungesën e progresit më të madh në procesin e deritashëm të dialogut. Por, vetë BE-ja përgjegjësinë për këtë ua lë palëve në dialog.

Kosova dhe Serbia janë në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve nga viti 2011. Procesi, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, ka nisur fillimisht për çështje teknike, për të kaluar më pas në nivel politik. Nga dhjetëra marrëveshjet e arritura deri më tash, shumica nuk janë zbatuar.

Nën Lajçakun, në vitin 2023, është arritur edhe marrëveshja drejt normalizimit të marrëdhënieve, e cila u bë e njohur si Marrëveshja e Ohrit, por edhe ajo ka mbetur kryesisht e pazbatuar.

Zgjedhjet evropiane, Kurti u drejtohet bashkatdhetarëve: Vota juaj duhet të jetë kundër rreziqeve që e kërcënojnë unitetin e BE-së



PRISHTINË, 5 QERSHOR - Këtë të diel, më 9 qershor, në 27 vende anëtare të Bashkimit Evropian, do të mbahen zgjedhjet evropiane, mbase më të rëndësishmet që prej zgjedhjeve të para evropiane të vitit 1979. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ka dhënë një mesazh për bashkatdhetarët e bashkëqytetarët që jetojnë nëpër shtete anëtare të Bashkimit Evropian e që kanë të

drejtë vote. Kurti ka shtuar se këto zgjedhje janë të rëndësishme për të ardhmen e Evropës. "Së pari ato ndodhin në rrethana ku një luftë e drejtpërdrejtë po ngjan mu në Evropë, në Ukrainë pas agresionit rus. Kjo luftë u nis prej një ideologjie fashiste nga Kremli i Putinit. Së dyti i keni parasysh ndasitë që ekzistojnë brenda BE-së dhe përbrenda vendeve anëtare. Përmes këtyre

ndasive, Rusia, duke u mbështetur gjithashtu në disa rryma politike ekstremiste ose liderë në pushtet të këtyre vendeve, ka ushtruar me vite një ndikim dëmtues. Qëllimi i Ruisë dhe aleatëve të saj evropianë jashtë dhe brenda BE-së është i qartë: dobësimi i BE-së, dobësimi i projektit të zgjerimit të BE-së dhe të NATO-s, ndërsa ndaj neve, veçanërisht në Kosovë, synohet pengesa e

çdo perspektive integruese. Kështu që së treti, Kosova si vend aplikoji për anëtarësim në BE dhe si vend që ka për qëllim strategjik kryesor integrimin në BE dhe në NATO, nuk mund të mos marrë pjesë e të mos kontribuojë në çfarëdo forme në ruajtjen e këtyre organizatave dhe vlerave demokratike që ndajmë me to", ka thënë Kurti. Sipas tij, vota e

bashkatdhetarëve në zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian duhet të jetë kontributi kundër rreziqeve që e kërcënojnë kohezionin dhe unitetin e BE-së. "Prandaj vota juaj në zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian të 9 qershorit duhet të jetë përgjigjja jonë, kontributi ynë kundër rreziqeve që e kërcënojnë kohezionin dhe unitetin e BE-së", u shpreh Kurti.

Peci: Serbët që punojnë në komunën e Zveçanit kanë frikë nga Lista Serbe



PRISHTINË, 5 QERSHOR - Serbët që jetojnë në komunat veriore kanë frikë të punojnë në institucionin publik me kryetarët shqiptarë nga hakmarrja e Listës Serbe. Edhe ata që aktualisht janë në marrëdhënie pune në komunën e Zveçanit kujdesen që të mos shfaqen në kamera, ndërsa rrugën për në punë e bëjnë me taksì në mënyrë që të mos identifikohen me veturat e

tyre. Kështu u shpreh për "A2CNN", kryetari i Zveçanit, Ilir Peci. "Unë i shoh edhe këta zyrtarë që janë këtu në komunë duke punuar kanë një frikë të madhe nga Lista Serbe. Udhëtojnë, sidomos një pjesë që është më afër në këmbë e të tjerët me taksì, e nuk guxojnë të vijnë me makinë të tyre që të shihen makinat e tyre para komunës se vetë kanë treguar se mund

t'u digjen nga ai grup. Me të vërtetë kanë frikë prej Listës Serbe", ka deklaruar Peci. Kur ka kaluar një vit që kur u ndryshuan pushtetet, në komunën e Zveçanit ende ka mungesë të zyrtarëve komunalë, megjithatë ata që janë duhet të kryejnë disa punë. "Na jemi shumë pak me zyrtarë. Kemi mungesë shumë të madhe të zyrtarëve, mirëpo sa për t'i plotësuar kërkesat e

qytetarëve mjaftojnë", ka thënë ai. Pas dështimit të referendumit për largimin e kryetarëve shqiptarë, kryetari i Zveçanit thotë se edhe qytetarët serbë kanë filluar t'i besojnë më shumë dhe tani ka deri në 80 kërkesa takime në ditë. "Në momentin kur shteti ua dha mundësinë për shkarkimin apo mosshkarkimin tonë si kryetar komune, nga ai

moment është në përmirësim. Çdo ditë kemi takime me qytetarë serbë që i takojnë komunës së Zveçanit. Është shumë më ndryshe sesa vitin e kaluar", ka thënë Peci. Kryetarët shqiptarë në komunat veriore u zgjodhën në prill të vitit 2023, ndërsa u konfirmuan në detyrë dy muaj më parë pas dështimit për largimin e tyre përmes petitionit.

LDK-ja dhe PSDhK-ja shkojnë bashkë në zgjedhje

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në selinë qendrore të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të mërkurën është nënshkruar marrëveshje parazgjedhore me Partinë Shqiptare Demokratike të Kosovës (PSHDK) për garimin e përbashkët në një listë zgjedhore, në listën e LDK-së, në zgjedhjet e ardhshme

nacionale. Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se ky bashkëpunim është rikthim në traditën e ndershme dhe të shëndoshë që nëpër dekada kanë pasur, që nga koha e ish-presidentit Rugova dhe profesor Mark Krasniqi. "Përbashkimi i së djathtës brenda listës së LDK-së, me

programin e LDK-së dhe me bindjet tona ideologjike që definojnë vet të ardhmen euroatlantike, është domosdoshmëri kombëtare! LDK-ja do të vazhdojë angazhimin në përbashkimin e së djathtës me partnerë të tjerë gjatë ditëve, javëve e muajve të ardhshëm!", ka thënë Abdixhiku.



Meloni në Shqipëri: Marrëveshja për emigrantët, model për vendet e tjera të BE-së

SHËNGJIN, 5 QERSHOR - Kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, ka vizituar të mërkurën dy qendrat për pritjen dhe strehimin e emigrantëve në Shëngjin dhe Gjadër në veriperëndim të Shqipërisë.

Me një marrëveshje me Romën, të nënshkruar në nëntor të vitit të kaluar, Tirana ka rënë dakord t'i pranojë azilkërkesit e kapur nga autoritetet italiane në Detin Mesdhe dhe t'i strehojë ata derisa kërkesat e tyre të përpunohen.

Duke folur në një konferencë për medie bashkë me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, Meloni ka thënë se kjo marrëveshje "po shërben si model për shtete të tjera të Bashkimit Evropian" pavarësisht prej kritikave nga opozita në të dy vendet.

"Emigracioni i jashtëligjshëm është fenomen shqetësues në BE. Asnjë shtet nuk mund ta përballojë i vetëm, por duhet edhe ndihma e vendeve të tjera të Bashkimit Evropian, si dhe e atyre jashtë BE-së. Nuk na mbetet tjetër veç ta



forcojmë këtë bashkëpunim", ka thënë Meloni.

Qendra për pranimin dhe strehimin e emigrantëve në Shëngjin, Shqipëri. Emigrantët e kapur nga Italia në Detin Mesdhe do të mbahen në këtë qendër derisa kërkesat e tyre për azil të shqyrtohen nga autoritetet italiane. Italia do ta financojë ngritjen e

qendrave të pritjes në Shëngjin dhe në Gjadër si dhe do t'i paguajë shpenzimet për sigurinë dhe kujdesin mjekësor të emigrantëve. Në Shqipëri opozita e ka kundërshtuar marrëveshjen, duke thënë se kishte mungesë transparence.

Meloni ka thënë se "15 vende të BE-së tashmë kanë firmosur dhe i kanë

dërguar një apel Komisionit Evropian për të kërkuar që të ndiqet ky shembull. Edhe vetë qeveria gjermane, ministri i saj i Brendshëm, këshilloi ndjekjen e këtij modeli".

Ndërkohë, Rama ka thënë se Shqipëria ka marrëdhënie të veçanta me Italinë dhe kjo është arsyeja pse ka bërë marrëveshje për

emigrantët me të. Ai ka thënë se Shqipëria i "ka refuzuar të tilla kërkesa" nga shtetet e tjera. "Këtë mundësi e kemi dhe këtë mund ta shfrytëzojmë vetëm me Italinë për 1 001 arsye, të së sotmes dhe të nesërme, nuk ka asnjë kalkulim tjetër... Do të funksionojë apo jo, këtë do ta tregojë koha, por kjo është një marrëveshje zemre, jo e bazuar në llogaritje", ka thënë Rama.

Sipas marrëveshjes, fillimisht pritet të strehohen rreth 3 000 persona, ndërsa në një vit fluksi emigrator mund të shkojë deri në 36 000 persona. Në qendrën e pritjes së emigrantëve në Shëngjin, punimet kanë përfunduar të martën mbërma, ndërsa në atë të Gjadrit punimet janë duke vazhduar.

Meloni ka thënë se të dyja qendrat do të jenë funksionale nga 1 gushti. Ajo e ka falënderuar homologun e vet Edi Rama për ndihmën që Shqipëria ka dhënë për çështjen e emigrantëve duke nënshkruar marrëveshjen me Italinë.

Hapet Panairi i 24-të i Librit në Prishtinë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në Pallatin e Rinisë, me moton "Përgjigja është libri", është hapur të mërkurën edicioni i 24-të i Panairit të Librit.

Në ceremoninë hapëse morën pjesë ministri Hajrulla Çeku, ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, zëvendësministri i Arsimit, Taulant Kelmendi, drejtoresha e Kulturës në Prishtinë, Sibel Halimi, mysafirë të veçantë ishin: shkrimtari francez Eric Faye, ambasadori i Shqipërisë, Petrit Malaj, kryetari Shoqatës së Botuesve të Kosovë, Edon

Zeneli, botues, autorë dhe lexues.

Ministri Çeku në fjalën e tij para të pranishmëve tha se Panairi i Librit është një nga traditat më të bukura në Kosovën e pasluftës, kur sheh gjithë këta botues e tituj të ri të librave që i ofrohen lexuesit, duke theksuar se institucionet në vazhdimësi duhet të jenë në dispozicion të botuesve dhe të autorëve.

Fjalë rasti mbajtën edhe ministrja Nagavci, drejtoresha e Kulturës në kryeqytet, Sibel Halimi, shkrimtari francez Eric

Faye dhe kryetari i Shoqatës së Botuesve të Kosovë, Edon Zeneli.

Në këtë edicion të Panairit të Librit marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora, ndërsa numri i titujve të rinj është rreth 2000 e i atyre të viteve të fundit 6 000 sosh.

Gjatë ditëve të panairit do të ketë edhe shumë aktivitete të tjera kulturore dhe letrare. Panairi do të jetë i hapur për vizitorë çdo ditë nga ora 9:00-21:00 deri më 9 qershor në orën 19:00.



Arrestohen dy persona për "spiunazh"

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi të mërkurën se ka arrestuar dy persona të dyshuar për "spiunazh". Në një njoftim për medie, Prokuroria tha se dy shtetasit kosovarë u arrestuan të mërkurën pas një hetimi disamujor dhe se

i ngarkon ata me veprën penale "spiunazh". "Sot në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe AKI-në është zhvilluar bastisje në dy lokacione të Kosovës dhe janë arrestuar dy persona me nënshtetësi kosovare, të dyshuar për kryerjen e veprës penale 'spiunazhi',

nga neni 124 i KPRK-së", thuhet në njoftim.

Ata janë ndaluar për 48 orë me vendim të prokurorit. Prokuroria tha se ndaj tyre do t'i ndërmarrë "të gjitha veprimet e nevojshme hetimore". Nuk u dhanë hollësi të tjera rreth këtij rasti.



“Duam ndryshim dhe e duam tani”, thirrja e ambientalistëve të rinj në Ditën Botërore të Mjedisit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINA, 5 QERSHOR - Zyra e UNICEF-it në Kosovë, në bashkëpunim me Ambasadën e Suedisë në Kosovë dhe partnerin implementues “Pen”, ka shënuar Ditën Botërore të Mjedisit, ku 100 ambientalistë të rinj bënë thirrje për veprim të menjëhershëm nga vendimmarrësit dhe aktorët e tjerë në mbrojtje të mjedisit. Të pranishëm në ngjarje ishin edhe ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama dhe ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Benjamin Fisher.

Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit u pasua nga një ekspozitë e heshtur e organizuar nga 100 të rinj, duke nxjerrë në pah çështje urgjente, si ndotja e ajrit, shpyllëzimi, mbeturinat, përmbytjet dhe valët e të nxehtit. Secili instalacion në ekspozitë barte një mesazh prekës, duke kërkuar veprime të menjëhershme në mbrojtje të

planetit tonë.

Ekspozita ishte një paraqitje në realitet e shprehjes “një fotografi sa një mijë fjalë”, pasi që vuri në pah shqetësimin e të rinjve për gjendjen aktuale të mjedisit. Për më tepër, mundësoi edhe një platformë fuqizuese për të rinjtë që t’i ndajnë përvojat e tyre personale për ndotjen e ajrit dhe çështje të tjera mjedisore.

Të rinjtë u bënë thirrje bashkëmohatarëve të tyre, shoqërisë kosovare, institucioneve lokale dhe kombëtare, të ndërmarrin veprime të menjëhershme që së bashku t’i zvogëlojnë emetimet e gazrave serrë. “Çdo individ sot lë gjurmë në emetimet e dyoksidit të karbonit dhe secili nga ne duhet t’i ndryshojë shprehitë në mënyrë që ta ruajmë planetin tonë”, ka theksuar Bardha, përfaqësuese e Rrjetit të Ambientalistëve të Rinj, duke kërkuar më shumë hapësirë që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh.

Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, ka pohuar se gjatë punës për Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Darfur



në vitin 2007, ka parë me sytë e tij se si shpyllëzimi ka nxitur konfliktin në Sudan. “Ta mbrojmë planetin duke u ruajtur pyjet dhe burimet ujore në Kosovë”, është shprehur Westerlund.

Ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Benjamin Fisher, përsëriti edhe një herë rëndësinë

e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve për mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm. “Duhet t’i dëgjojmë zërat e të rinjve dhe të veprojmë në lidhje me shqetësimet e tyre. Ata jo vetëm që e trashëgojnë këtë planet, por janë edhe partnerët tanë në ndryshim”, ka thënë ai.

Dita Botërore e Mjedisit

inkurajon vetëdijesim dhe veprim për mbrojtje të mjedisit, mbështetur nga OJQ-të, bizneset dhe qeveritë. Ngjarja e këtij viti në Kosovë pohoi edhe një herë rolin kritik që e kanë të rinjtë për të avokuar për një të ardhme të qëndrueshme. Kjo ngjarje theksoi nevojën urgjente për veprim të menjëhershëm kundër ndryshimit klimatik.

Kryeprokurori i Shtetit: Uebportali i ri afron sistemin prokurorial me publikun, median dhe shoqërinë civile



PRISHTINE, 5 QERSHOR - Në ceremoninë e lansimit të uebportalit të ri të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur një fjalë rasti, ku ka theksuar se kjo dritare e informacionit që po lansohet sot do të jetë një mënyrë e mirë që secili qytetar, organizatë e shoqërisë civile apo media, të ketë informacione më të plota dhe në kohë reale, në mënyrë që imazhi i Prokurorit të Shtetit dhe sistemit prokurorial të avancohet,

siç është duke u avancuar çdo ditë dhe për këtë ka falënderuar shoqërinë civile dhe mediet të cilat po ndikojnë që të rritet besimi i publikut në punën e Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu, ai i ka inkurajuar qytetarët, mediet dhe shoqërinë civile t’i shfrytëzojnë mundësitë dhe qasjen që sistemi prokurorial po ua jep atyre, siç është kjo e uebportalit të ri ku do të mund të kenë informacione më të shumta për punën që e bën Prokurori i Shtetit, sepse është duke u bërë punë e madhe.

Kelmendi ka falënderuar UNDP-në e cila e ka mbështetur këtë projekt.

Dizajnimi dhe zhvillimi i uebportalit të ri të sistemit prokurorial është mundësuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, konkretisht nga projekti “Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit, SAEK III”, përmes ndihmës së Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Suedisë dhe do të jetë në shërbim të medieve, të shoqërisë civile dhe të të gjithë qytetarëve të vendit.

Policia realizon fushatën “Mos rrezikoni fëmijët tuaj”

MITROVICË, 5 QERSHOR - Policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut është duke realizuar fushatën vetëdijesimi me moton “Mos rrezikoni fëmijët tuaj”.

Shoferi i cili gjatë drejtimit të mjetit mban të ulur në prehrin e tij në timon ndonjë person tjetër, do të gjobitet 400 euro, do të ketë masë mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej gjashtë muaj dhe pesë pikë negative. “Me qëllim të parandalimit dhe

rritjes së masave të sigurisë në trafikun rrugor, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut është duke realizuar fushatë vetëdijesimi për drejtuesit e mjeteve, referuar Ligjit të ri për Rregullat e Trafikut Rrugor, dispozitat e të cilit parashohin gjoba për shoferët që drejtojnë mjetet me fëmijë të ulur në prehrin. Me qëllim të sensibilizimit të shoferëve, në kuadër të kësaj fushate janë duke u shpërndarë fletushka me moton ‘Mos rrezikoni fëmijët



tuaj’. Krahas shpërndarjes së fletushkave, policia në

vazhdimësi po i informon drejtuesit e mjeteve për

pasojat dhe masat ndëshkimore që parashihen me dispozitat e Ligjit për Rregullat në Trafik, përkatësisht Neni 189.10 dënohet për kundërvajtje shoferi i mjetit i cili gjatë drejtimit të mjetit mban të ulur në prehrin e tij në timon ndonjë person tjetër, me gjobë prej katërqind (400) eurosh, masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, si dhe pesë (5) pikë negative”, ka njoftuar policia.

BQK-ja forcon kornizën rregullatore dhe agjendën e reformës institucionale, sistemi bankar mbetet i shëndoshë

EPOKA E ENJTE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka marrë vlerësim të lartë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pas përfundimit të suksesshëm të rishikimit të dytë të programeve Stand-By Arrangement (SBA) dhe Resilience and Sustainability Facility (RSF). Rishikimi i FMN-së thekson përkushtimin e BQK-së për reformën ambicioze institucionale, duke përfshirë rregulloret e reja të miratuara. FMN-ja ka vlerësuar miratimin nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të Rregullores së re për Operacionet me Para të Gatshme si të rëndësishme për përmirësimin e sistemit të pagesave, fuqizimin e kontrollit mbi qarkullimin e valutës, luftimin e parave të falsifikuara dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Rregullorja në fjalë rregullon përdorimin e euros si valutë e

vetme ligjore për pagesa, ndalon funksionimin e institucioneve financiare të palicencuara dhe dekurajon transaksionet e mëdha me para të gatshme duke ndaluar riciklimin e bankënotave prej 500 eurosh. Këto masa kanë kontribuar në një mjedis financiar më të shëndetshëm, më të sigurt dhe më transparent, pavarësisht nga sfidat dhe efektet anësore. Në lidhje me qeverisjen, BQK-ja po zbaton rekomandimet nga Vlerësimi i Masave Mbrojtëse (Safeguard Assessment) për ta forcuar qeverisjen e brendshme, menaxhimin e rrezikut dhe kornizën e stres-testit. Kjo përfshin kompletimin e Bordit Ekzekutiv sipas strukturës së re organizative dhe nxjerrjen e "Rregullave të Procedurës" për ta përmirësuar transparencën dhe efikasitetin. Përpjekjet për ta forcuar menaxhimin e rrezikut përfshijnë krijimin e një Komiteti të Rrezikut ndër-departmental të nivelit të lartë dhe emërimin e një drejtori të ri për Departamentin e Menaxhimit të Rrezikut dhe iniciativa të tjera në



vazhdim për t'i adresuar sfidat e sigurisë kibernetike. BQK-ja, gjithashtu, ka finalizuar Ligjin e ri për Banka për t'i përmirësuar kriteret e licencimit, standardizuar operacionet dhe forcuar proceset e përmbylljes dhe likuidimit. Me mbështetjen e Bankës Botërore (BB) dhe Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) janë duke u finalizuar ligje të reja mbi institucionet mikrofinanciare dhe shërbimet e pagesave. Më tutje, institucioni kryesor

financiar në vend vazhdon t'i forcojë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut bazuar në rekomandimet e raportit të Vlerësimit të Masave Mbrojtëse të FMN-së. Përveç kësaj, BQK-ja ka theksuar se po punon në Agjendën e Gjellbër të sistemit financiar duke udhëzuar bankat të monitorojnë dhe raportojnë të dhëna të lidhura me rreziqet klimatike. "Bashkëpunimi me BB-në synon ta forcojë kornizën rregullatore

për t'i menaxhuar rreziqet mjedisore dhe rreziqet e ndërlidhura me klimën për sektorin bankar. Vlerësimi i FMN-së, gjithashtu, pranon se sistemi bankar mbetet i shëndoshë, bankat janë mirë të kapitalizuara, mirë të provizionuara, me likuiditet të lartë dhe profitabilitet. Kreditë joperformuese (NPL) kanë mbetur të ulëta dhe rritja reale e kreditimit, veçanërisht në kreditimin e ekonomive familjare, ka qenë adekuate. Vlerësimi pozitiv i FMN-së nënvizon qasjen proaktive të BQK-së për ta forcuar qeverisjen, stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë, duke pozicionuar sektorin financiar të Republikës së Kosovës për rritje dhe qëndrueshmëri të vazhdueshme. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shpreh konsideratën më të lartë për stafin e Misionit të FMN-së për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe diskutimet e vlefshme dhe mbështetjen e vazhdueshme në fusha të ndryshme", ka theksuar BQK-ja.

Bilanci i pagesave në tremujorin e parë shënon rritje prej 68.61 milionë eurosh

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës ka publikuar statistikat e Bilancit të Pagesave (BP) për muajin mars 2024. Bilanci i pagesave në tremujorin e parë 2024 u karakterizua me deficit të llogarisë rrjedhëse në vlerë prej 295.81 milionë eurosh, i cili tregoi rritje prej 68.61 milionë eurosh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht i ndikuar nga rritja e importit të mallrave dhe zbutur nga rritja e llogarisë dytësore.



Bilanci tregtar në mallra për tre muajt e parë të vitit 2024 shënoi deficit në vlerë 1,050.67 milionë euro, i cili është për 11.53 % më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Eksporti për këtë periudhë shënoi vlerën 212.31 milionë euro, duke paraqitur rënie vjetore prej 2.09 %,

ndërsa importi i mallrave shënoi vlerën 1,262.98 milionë euro duke paraqitur rritje vjetore prej 8.98 %. Llogaria e shërbimeve, e cila vazhdimisht ka bilanc pozitiv, në tremujorin e parë 2024 shënoi vlerën 261.89 milionë euro, e cila është për 1.10 % më i lartë

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit kaluar. Të ardhurat parësore në periudhën janar-mars 2024 shënuan bilanc pozitiv prej 56.32 milionë eurosh, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kishte vlerën 7.54 milionë euro.

Rritja e kësaj kategorie është ndikuar pothuajse në të njëjtën peshë nga rritja e kompensimit të punonjësve dhe të ardhurat nga investimet. Të ardhurat dytësore mbeten kontribuueset kryesore në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deri në mars 2024 kjo llogari shënoi bilanc pozitiv prej 436.65 milionë eurosh, e cila paraqet rënie prej 2.60 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit kaluar. Remitancat janë kategoria kryesore në kuadër të të ardhurave dytësore, vlera e të cilave për tre muajt e parë të 2024 shënoi 281.02 milionë euro, e cila përfaqëson rritje prej 9.76 milionë eurosh ose 3.60 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Asetet në llogarinë financiare në

tremujorin e parë të këtij viti kanë shënuar bilanc negativ për 32.74 milionë euro, ndërsa detyrimet financiare kanë shënuar bilanc pozitiv në vlerë prej 171.16 milionë eurosh. Investimet direkte në Kosovë deri në fund të marsit 2024 ishin 185.39 milionë euro, vlerë pothuajse e njëjtë me atë të vitit paraprak (189.58 milionë euro në TM1 2023), ndërsa investimet direkte jashtë Kosovës shënuan vlerën 39.71 milionë euro (49.14 milionë euro në TM1 2023). Asetet rezervë deri në mars 2024 kanë arritur vlerën e përgjithshme në 1,162.0 miliardë euro. Vlera e aseteve rezervë në tremujorin e parë të vitit 2024 ka shënuar një zvogëlim prej 18.70 milionë eurosh, e ndikuar kryesisht nga maturimi i letrave me vlerë.

Rizvanolli dhe Lorkowski diskutojnë për gjendjen aktuale të energjisë elektrike në Kosovë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka takuar drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Evropë, Artur Lorkowski dhe delegacionin e tij. Në një takim të gjatë dhe frytdhënës u diskutua për gjendjen aktuale të energjisë elektrike në Kosovë dhe investimet që e presin Kosovën në këtë sektor. Ministrja Rizvanolli theksoi

se sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Evropë e ka mbështetur Kosovën në shumë procese të rëndësishme, përfshirë këtu edhe rreth kornizës ligjore dhe menaxhimit të krizës energjetike, për çfarë edhe e falënderoi zotin Lorkowski për përkrahjen. Gjatë takimit, po ashtu, u trajtuan edhe çështjet më të rëndësishme aktuale të energjisë, në veçanti për

Planin Kombëtar të Kosovës për Energji dhe Klimë (NECP), Harmonizimin e Politikave Mjedisore me Politikave Evropiane (ETS) dhe Marrëveshjen për Tregun e Energjisë Elektrike. Përveç kësaj, me theks të veçantë u diskutuan edhe sfidat aktuale dhe proceset e lehtësimet që mund të ofrojë Bashkimi Evropian në rrugën drejt transformimit energjetik të vendit.



‘Der Spiegel’, reportazh i vitit 1981 nga Shqipëria: Në Kopshtin e Edenit, një idhull prej graniti



Nga: Fritjof MEYER /
Der Spiegel, 1981

Vendi është komunist, por pothuajse askund, madje as në Amerikën e Ronald Reaganit, nuk janë publikuar karikatura kaq të egra si të Brezhnev-it ashtu edhe të Maos. Heroi kombëtar Skënderbeu, emrin e të cilit mban emrin sheshi qendror në kryeqytetin Tiranë, një klub futbollit dhe një pije alkooolike. Ai ishte katolik praktikant, i cili u zgjodh nga Papa për të udhëhequr një kryqëzatë në Tokën e Shenjtë. Por, katolicizmi, si çdo praktikë tjetër e fesë, dënohet me ligj; edhe posedimi i Biblës dënohet me vdekje, me pushkatim. Marrja e kredive të huaja është e ndaluar me Kushtetutë. Megjithatë, 200 milionë dollarë erdhën në vend nga Bashkimi Sovjetik, dhe madje, pesë miliardë – sipas Pekinit – nga Kina. Dhe, kur njerëzit në këtë vend votuan tre vjet më parë, çdo qytetar i jepte votën e tij partisë shtetërore, saktësisht 100 për qind (në Republikën Demokratike Gjermane, ishte vetëm 99,86 për qind në qershor 1981). Një votues i vetëm me të drejtë vote, nuk e ushtroi të drejtën e tij për të votuar. Shefi i madh i Shqipërisë, është një intelektual që ka pasur përvojën e tij arsimore në Francë. Ai sillet si feudal. Fakti që subjektet e tij tundin kokën kur bien dakord, por tundin kokën dhe thonë “po” kur

nënkuptojnë “jo”, konsiderohet një relike nga Orienti.

Në Shqipëri, ku njerëzit ende i bëjnë homazhe Jozef Stalinit – edhe pse monumenti i tij tani qëndron në një vend ku nuk bie kurrë rreze dielli; në Shqipëri ku propagandohet jeta e thjeshtë, por në të njëjtën kohë zyrtarët dhe familjet e tyre shkojnë te një fisnik, Shtëpiza e Gjuetisë (Hoteli i Gjuetisë në periferi të Lezhës) që dikur shërbente si strehë për fashistin Italian, Kontin Ciano – në Shqipëri gjithçka është ndryshe.

2.7 milionë banorët nuk e quajnë veten as shqiptarë, por “Skipetaren” (“Bijtë e shqiponjave”), siç e thoshte tashmë Karl May. Prandaj, shteti i tyre quhet “Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë”. Dhe, krahasuar me Republikën Demokratike Gjermane e rrethuar me mure, ai është shteti më i izoluar në botë në Adriatik dhe megjithatë duket si në një planet tjetër.

Hyrja në rajonin malor të paarrtshëm është e mundur vetëm në një pikë kufitare në veri, në liqenin gjysmë-jugosllav, gjysmë shqiptar të Shkodrës dhe nëpërmjet aeroportit të vogël të Rinasit në periferinë e kryeqytetit të Tiranës, ku një avion çekoslovak ose gjermano-lindor mbërrin dy herë në javë dhe “Olympic Airways” greke që janë “ulur” dikur.

Delegacionet e vizitorëve, të zgjedhur me dorë nga misionet diplomatike të Shqipërisë në vendet e huaja (vizat individuale nuk janë të disponueshme), duhet

t’i nënshtrohen kontrolleve rigorozë: Në deklaratën doganore kërkohet marka e kamerës dhe çdo gjë që është sjellë me vete, si dhe një orë dore, apo dhe orën me zile, si dhe për revistat dhe librat që janë sjellë individualisht. Deklarata e përmbajtjes do të listohet; ndalohet rreptësisht importimi i Biblës, ose literaturës tjetër fetare.

Fëmijët e vendit, të mbajtur me kujdes larg tundimeve, nuk duhet të terrorizohen nga konsumi i lartë, të shpërqendrohen nga idetë e huaja ose – ndaj të cilave ata me sa duket janë veçanërisht të ndjeshëm – të ekspozohen sërish ndaj besimit te perënditë e vjetra. Ata gjithashtu nuk duhet të njohin ndonjë modë të huaj e të panjohur, që mund t’i iritojë papritur.

Kjo është arsyeja pse mysafiri i huaj nuk lejohet të veshë një fund mini ose maksi, ose pantallona tepër të gjera, ose të ngushta lëkure dhe për emigrantët meshkuj, flokët e gjatë femërore dhe mjekra e plotë janë të ndaluara: “Pjesa midis veshit dhe mjekrës, duhet të jetë pa mjekër”, rekomandon një fletë-palose. (fq. 147)

Jo shumë kohë më parë, në aeroport një berber qëndronte gati për të shkurtuar “dhnuesit” e këtij rregulli – në një dhomë ngjitur. Më në fund, Karl Marxi dhe Friedrich Engelsi varen në sallën e pritjes, me faqet dendur të rritura, nga mustaqet e mjekra e gjatë.

Në qoshet e fshehura të qytetit të vjetër, të kryeqytetit Tiranë, i huaji shfaqet shpesh si i huaji i parë në

dekada – e shikon me kuriozitet të jashtëzakonshëm, pa e kthyer kokën, pastaj kalon rrugën e vet, por e shikon vetëm nga cepi i syrit. “Skipetarët” nuk u përgjigjen përshëndetjeve, tërhiqen nga biseda të shqetësuar dhe fëmijët që tundin duart duke përshëndetur marrin një shuplakë në dorë, nga nëna e tyre.

Një pritje e veçantë për vizitorët pafesë në Shqipëri, është paralajmëruar tashmë në aeroportin e Tiranës: rreth pistës, vendi ku si kudo në Republikën e “Skipetarit” është me pika dhe të veshura me hemisfera të vogla prej betoni, të hapura nga pas. Front: bunker kundër një armiku të mundshëm.

Ka me dhjetëra të tilla në fusha dhe oborre shkollash, në kryqëzimet e rrugëve dhe në majat e maleve. Ashtu si lia e dhenve, e gjithë “Republika Popullore Socialiste Skipetare” është e mbuluar nga dhjetëra mijëra ndërtesa të stilit komunist.

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak prej tre vitesh, plus një muaj në çdo vit pasardhës, zbatohet si për meshkujt. Përshëndetja ushtarake është grushti i ngritur, bazuar në modelin e Shoqatës Gjermane të Luftëtarëve të Frontit të Kuq të epokës së Vajmarit. Kushtetuta parashikon dënimin me vdekje për dorëzimin tek armiku në kohë lufte. Deri më tani, qëkur janë ndërtuar tre vjet më parë, bunkerët kanë “trembur” çdo kundërshtar. Në disa raste betoni tashmë po

shkërmoqet, në të tjera lulet po rriten nga humusi që është grumbulluar për maskim. Vetëm zinxhirët e bunkerit në aeroport, nën pemët e mollëve, janë të zëna nga ushtarët.

“Ju prisni”, shpjegon Aleks Buda, historiani i sofistikuar dhe presidenti i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me kuptim dhe në të njëjtën kohë shpërfillës, për këtë masë paraprake unike.

Ata janë duke pritur – dhe për arsye të mira: “Gjatë gjithë historisë së saj, Shqipëria ka qenë gjithmonë një pre e fqinjëve të saj, një zonë tranziti për njerëzit e fuqishëm nga të katër anët – grekët dhe romakët, hunët dhe ostrogotët, normanët dhe sllavët, bizantinët dhe turqit, të cilët u përzien me ilirët ekzistues dhe u imponuan fetë e tyre – veçanërisht të suksesshëm rezultuan turqit, të cilët qëndruan me shekuj dhe i prenë shqiptarët nga Evropa, ashtu siç i prenë tatarët dikur rusët ose siç i prenë komunistët tani, shqiptarët. Shqipëria, përndryshe ksenofobike e komunistëve, e lejoji veten të industrializohej fillimisht nga Bashkimi Sovjetik, pastaj nga Kina dhe tani e ka prishur me të dy superfuqitë e kuqe, me fqinjët Jugosllavinë komuniste, gjithsesi – grindjet ballkanike në të cilat një luftë botërore mund të ndizet sërish, siç e ka parashikuar tashmë një film televiziv italian.

Irredenta e Shqipërisë, rajoni i Kosovës i populluar me shqiptarë, por pjesë e Jugosllavisë, ka qenë në revoltë të hapur kundër dominimit

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Shqipëria kryen seancën e radhës stërvitore në Austri

VJENË, 5 QERSHOR - Kombëtarja shqiptare po vijon përgatitjet në Austri, teksa të mërkurën e gjithë skuadra ka qenë e plotë dhe ka kryer seancën e radhës stërvitore. Departamenti i Komunikimit në FSHF bën me dije se i gjithë grupi është stërvitur nga urdhrat e trajnerit Silvinjo dhe stafit teknik.

Të gjithë lojtarët gëzojnë formë të mirë fizike dhe në ndeshjen e së premtes ndaj Azerbajxhanit do të jenë të gatshëm edhe Berat Gjimeshi, Taulant Seferi, Amir Abrashi, Ylber Ramadani dhe Simon Simoni të cilët u lanë pushim në ndeshjen ndaj Lihtenshtejnit. Kombëtarja

kuqezi vijon me përgatitjet intensive në kuadër të Kampionatit Evropian "Gjermani 2024", ndërsa të premtën Shqipëria do ta zhvillojë edhe ndeshjen e dytë miqësore ndaj Azerbajxhanit në stadiumin "Haladas Sportkomplexum" në orën 19:00.



FBK-ja paraqet përzgjedhësin e Përfaqësueses së Kosovës për femra

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në një konferencë për medie ka paraqitur përzgjedhësin e Kosovës A të femrat, Viktor Kovaq, si dhe ka shpalosur detajet e pesë organizimeve që do t'i ketë FBK gjatë kësaj vere. Në fillim të konferencës është shfaqur spoti i FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla, që shënon edhe fillimin e kampanjës për këtë event të rëndësishëm. "Është kënaqësi e veçantë që sot jemi mbledhur këtu për të ndarë lajme të rëndësishme dhe për ta prezantuar programin e aktiviteteve të Federatës së Basketbollit të Kosovës për periudhën qershor-korrik 2024. Ne kemi planifikuar një sërë ngjarjesh madhështore në bashkëpunim me FIBA-n dhe FIBA 3x3, që do të zhvillohen në Prishtinë. Ky është një hap i rëndësishëm për basketbollin tonë dhe për sportin në Kosovë në përgjithësi", ka thënë kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, duke folur për pesë ngjarjet që do t'i organizojë FBK-ja. I pari i basketbollit të Kosovës më pas ka shtuar se: "Fokusi i FBK-së



është në avancimin e basketbollit të femrave dhe kjo dëshmohet edhe me këto gara që po i organizojmë në vendin tonë. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla do të synojmë rezultatin sa më të mirë sportiv, derisa FBK-ja do të mundohet ta organizojë në mënyrën më të mirë të mundshme".

Përzgjedhësi i Kosovës të Femrat, Viktor Kovaq, u shpreh i nderuar që FBK-ja i ka besuar një detyrë kaq të rëndësishme. "Jam i nderuar dhe do të mundohemi të japim më të mirën për Kosovën në një ngjarje të

tillë të rëndësishme", ka theksuar Kovaq, i cili do t'i drejtojë "Dardanet" në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla që mbahet nga 25 deri më 30 qershor në Prishtinë. Menaxheri i Përfaqësueses të Kosovës, Adriatik Rraci, ka folur për përgatitjet e vashave "dardane". "Përgatitjet e Kosovës A kanë filluar më 30 maj dhe deri më tani kanë shkuar shumë mirë. Shpresoj dhe besoj se do të dalim nga grupi e të kualifikohemi në gjysmëfinale. Ndërkohë, dua t'i falënderoj basketbollistët e

Kosovës që kanë treguar përkushtim dhe po stërviten maksimalisht për këtë Evropian", ka theksuar Rraci. Kjo është hera e tretë që Kosova do të garojë në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla, derisa hera e parë që organizohet në vendin tonë. Arbnore Përçuku u shpreh e lumtur që është kapitene, derisa foli edhe për atmosferën në ekip. "Jam shumë e lumtur dhe e nderuar që jam kapitene e Kosovës. Dua të theksoj se atmosfera te Kosova është shumë e mirë, derisa kemi një ekip të ri, ndoshta rreth 22 vjeç, por po japim më të mirën dhe shpresojmë në paraqitje të mira". Basketbollistja e talentuar Astera Tuhina nënvizoi se do të mundohen të kenë paraqitje sa më të mira. "Edhe unë kam kënaqësinë që të jem pjesë e Kosovës A. Synojmë të dalim të parat në grup dhe të kualifikohemi në gjysmëfinale, por do të mundohemi të fitojmë sa më shumë ndeshje", ka deklaruar Tuhina. Në fund është nënshkruar kontrata për Kovaqin nga trajneri dhe i pari i basketbollit të Kosovës, i cili i ka

dhuruar një fanellë me numrin 1. Kosova është në Grupin A së bashku me Gjeorgjinë, Qipron dhe Maltën, derisa në Grupin B bëjnë pjesë: Shqipëria, Norvegjia, Andorra dhe Armenia.

Federata e Basketbollit e Kosovës gjatë verës do të organizojë pesë ngjarje ndërkombëtare:

Federata e Basketbollit e Kosovës gjatë verës do të organizojë pesë ngjarje ndërkombëtare:

FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier, 8-9 Qershor, sheshi "Skënderbeu" në Prishtinë

FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla - Femrat, 25-30 qershor, Prishtinë

FIBA 3x3 Women's Series dhe FIBA 3x3 Challenger Prishtina, 18-21 korrik, Sheshi "Zahir Pajaziti" në Prishtinë

FIBA U18 Kampionati Evropian, Divizioni C për Femra, 23-28 korrik, Prishtinë

Suhareka transferon Lorik Boshnjakun



SUHAREKË, 5 QERSHOR - Skuadra e futbollit "FC Suhareka", e cila u inkuadrua këtë sezon në Superligën e Kosovës, ka bërë transferimin e parë për këtë afat kalimtar. Bëhet fjalë për mesfushorin Lorik Boshnjaku i cili i bashkohet klubit të Suharekës me një kontratë trevjeçare. Boshnjaku para transferimit në Suharekë luante në Superiorene e Shqipërisë dhe

ishite pjesë e ekipit të Vllaznisë. "Ju prezantojmë transferimin e ri dhe të parin për këtë merkato, mesfushorin Lorik Boshnjaku, i cili bashkohet me klubin tonë me kontratë trevjeçare. Pas një eksperience në Shqipëri te Vllaznia, Boshnjaku rikthehet në futbollin kosovar ku më parë ishte pjesë e Prishtinës për vite të tëra. Prezantimi i futbollistit është bërë në ambientet e BSR

Group në pronësinë e aksionarit tonë të klubit, Shaqir Rrahmanaj. Gjithashtu në prezantim të futbollistit ishte i pranishëm presidenti i klubit Rrustem Aliaj, Jetmir Bytyqi dhe drejtori menaxherial Bajram Sherifi që udhëtuan drejt Zvicrës për ta nënshkruar kontratën. Në ditët në vijim do të bëhet prezantimi në fanellat e FC Suhareka", thuhet në njoftimin e Suharekës.

Glasgow Rangers synon transferimin e Rrahmanit

GLASGOW, 5 QERSHOR - Albion Rrahmani është bërë objektivi i klubeve të njohura evropiane falë paraqitjeve fantastike që i shfaqti në këtë edicion në Rumani. Interesim për futbollistin kosovar ka edhe

nga Britania e Madhe, respektivisht nga Skocia. Gjiganti i këtij vendi, Glasgow Rangers, thuhet se është duke e përgatitur terrenin në tentim për ta transferuar përfaqësuesin kosovar,

shkruan "onefootball". Rangers nuk është ekipi i vetëm që ka shfaqur interesim për ish-sulmuesin e Malishevës dhe të Ballkanit. Atë e duan edhe AstonVilla, Napoli, Benfica, Dinamo

Zagreb, Ludogoretsi dhe Ferencvarosi. Rrahmani i ka realizuar 19 gola në sezonin 2023/24, përfshirë këtu 13 në Superligën rumune, katër në fazën e "play-off"-it të kësaj lige dhe dy në fazën



eliminatore të Ligës së Konferencës, ndërsa i kishte edhe pesë asistime në total.

Conte emërohet trajner i Napolit

NAPOLI, 5 QERSHOR - Antonio Conte është zyrtarisht trajner i ri i Napolit, me teknikun italian që është paraqitur nga Klubi i Serisë A. Ai ka firmosur një kontratë deri në vitin 2027, teksa objektivi është të rikthejë edhe njëherë në majë Napolin. "Jam

shumë krenar që trajneri i ri i Napolit është Antonio Conte. Antonio është një trajner i madh, një lider, me të cilin jam i sigurt se rithemelimi i nevojshëm mund të fillojë pas përfundimit të ciklit që na çoi në fitimin e kampionatit vitin e

kaluar. Pas shumë sezonesh në majat e futbollit italian, hapet sot një kapitull i ri i rëndësishëm në historinë e Napolit", ka deklaruar presidenti Aurelio De Laurentiis. Nga ana tjetër, tekniku 54-vjeçar u shpreh: "Napoli është një vend me

rëndësi globale. Jam i lumtur dhe i emocionuar me idenë për t'u ulur në stolin blu. Sigurisht që mund të premtoj një gjë: do të bëj maksimumin për rritjen e ekipit dhe klubit. Përkushtimi im së bashku me atë të stafit tim do të jetë i madh".



Sylvinho për UEFA-n: Asllani lojtar i madh, Asani ka goditje të shkëlqyer

TIRANË, 5 MAJ - Shqipëria vijon ta tërheqë vëmendjen e medieive ndërkombëtare, por dhe të UEFA-s. Së fundmi, i ftuar special i UEFA-s ishte Sylvinho. Trajneri i Kombëtares u rikthye pas në kohë, duke folur për fillimin e aventurës së tij në tokën e shqiponjave, ndërsa u ndal edhe te dy nga lojtarët e tij kryesorë, Asllani dhe Jasir Asani. "Kristjan është një lojtar me dhunti teknike, i shkëlqyer me të dyja këmbët. Ai është i aftë të luajë në të dyja anët. Ai është teknik, i ri dhe po krijon rrugën e tij. Ai ka ende shumë për të mësuar, si çdo lojtar 21 ose 22-vjeçar. Ai është vërtet i fortë për sa iu përket aftësive të tij teknike dhe është i bekuar me shumë personalitet. Ai është një lojtar i madh. Asani është një lojtar që kemi gjetur në Korenë e Jugut. Ai është një lojtar me këmbën e majtë që luan në të djathtë dhe futet në qendër, gjë që na pëlqen. Ai shënon gola të



rëndësishëm dhe të bukur, si ato kundër Polonisë dhe Moldavisë. Ai është një lojtar i madh me cilësi të lartë, i cili ka një goditje të shkëlqyer nga distanca. Ai me të vërtetë po i bën vend vetes në ekipin kombëtar", ka thënë Sylvinho. "Të jem i singjertë, është e mrekullueshme. Kemi arritur gjëra, kemi arritur në 'Euro2024'. Kjo është një arritje. Ndjesia kryesore është entuziazmi dhe lumturia. Njerëzit janë me të

vërtetë të lumtur. Ne kemi arritur deri këtu, ne e dimë se sa jemi, por ne jemi duke u përmirësuar. Do të jetë një sfidë e vërtetë. Megjithatë, ne do t'i futemi punës. Ndeshjet do të jenë fantastike, por të vështira, dhe nëse do të jemi në gjendje të mposhtim kundërshtarët tanë, ne duam të vazhdojmë. Ne po bëjmë mirë, por nëse do të mund të bënim një hap tjetër përpara, atëherë edhe më mirë", ka deklaruar Sylvinho.

Red Bulli konfirmon Perezin në krah të Verstappenit për dy sezonet e ardhshme

SHTUTTGART, 5 MAJ - Makina Red Bull Racing ka vendosur t'ia rinovojë kontratën edhe për dy vjet të tjera pilotit meksikan Sergio Perez. Ai do të garojë me makinën kampione deri në vitin 2026. "Jam shumë i lumtur që do të vazhdoj të garoj me këtë skuadër", ka thënë Perez. "Është një sfidë të garosh për Red Bullin. Dua t'i falënderoj të gjithë për besimin dhe dua t'ua shpërblej në pistë. Mendoj se kemi shumë punë për të bërë dhe shumë kampione të tjerë për të fituar së bashku", u shpreh meksikani. Edhe shefi Christian Horner foli për mediet, duke thënë: "Jemi të lumtur që do të vazhdojmë të



punojmë së bashku. Vijueshmëria e stabiliteti janë të rëndësishëm për skuadrën tonë. Dyshja Verstappen-Perez është e konsoliduar prej vitesh". Kontrata e re do t'i japë mundësi meksikanit të garojë me

Red Bullin në Formula 1 deri në moshën 36-vjeçare. Kjo i mbyll derën Carlos Sainz, që mund ta zëvendësonte vitin tjetër. "Kemi besim se Sergio do t'i rikthehet podiumit", ka deklaruar Horner.

SHKURT

Lista e Zvicrës, dy shqiptarë mbesin jashtë 'Euro 2024'

Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin dhe stafi i tij e kanë bërë shkurtimin e dytë të listës pas ndeshjes miqësore me Estoninë. E pjesë e këtij shkurtimi janë katër futbollistë, përfshirë këtu edhe dy futbollistë shqiptarë. Bëhet fjalë për Uran Bislimin e Albin Hajdarin, plus Filip Ugriniq e Kevin Mbabu, të cilët mbeten jashtë listës definitive përkundër paraqitjeve të mira në stërvitje. "Jemi marrë vesh me ta që të mos na bashkohen në San Gallen për ditët e para-kampionatit. Por, ata do të mbesin në formë individuale në mënyrë që të jenë të gatshëm nëse do të kemi nevojë për ta gjatë Evropianit", deklaroi trajneri Yakin. Aktualisht, pjesë e Zvicrës janë Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri, Andi Zeqiri e Ardon Jashari.

Laporta: Reali është skuadra e favorizuar nga gjyqtarët

Presidenti i skuadrës së Barcelonës, Joan Laporta, ka vazhduar ta sulmojë rivalin e tyre në urreyer, Real Madridin. Laporta po përpiqet maksimalisht për ta mbrojtur skuadrën e tij, por është tronditëse që ai ende arrin të përmend Real Madridin në ankimet e tij. Ai ka deklaruar se Reali po favorizohet nga gjyqtarët. "Real Madridi është skuadra e favorizuar nga gjyqtarët", ka thënë fillimisht presidenti i Barcelonës për mediet. "Ne nuk kemi blerë kurrë gjyqtarë. Do të shpallemi të pafajshëm sepse tezat e kundërta nuk kanë asnjë bazë dhe asnjë mënyrë për ta vërtetuar sepse nuk ekziston", ka shtuar Laporta. Ndryshe, Barça është skuadra e akuzuar për ryshfet për gjyqtarët për gati dy dekada, por ende nuk janë vërtetuar akuzat dhe hetimet që janë ende në vazhdim.

Lazio interesohet për Manajn, Sivasspori kërkon 15 milionë euro

Rey Manaj e ka mbyllur praktikisht me Sivassporin, ky ishte sezoni i tij i parë dhe i fundit në Turqi, pasi sulmuesi kuqezi pritet të rikthehet edhe një herë në futbollin e rëndësishëm evropian. Oferta për Manajn janë të shumta, pasi shifrat e tij këtë edicion ishin fantastike, 22 gola. Manaj, por dhe Sivasspori, shpresojnë që Evropiani të ketë edhe një imapkt më të madh, por shumë klube kërkojnë t'i paraprijnë kësaj duke trokitur në dyert e klubit turk me oferta konkrete. Së fundmi, emri i Manajt ka dalë edhe në kryeqytetin italian pasi, sipas medieive, interes për Manaj ka shfaqur edhe ekipi i Lazios. Manaj është një profil që në Serinë A e njohin mirë, pasi në të kaluarën Rey ka luajtur për ekipe të ndryshe si Cremonse, Inter, Pescara, Pisa dhe Spezia. "TuttomercatoWeb" shkruan se Sivasspori është i hapur për negociatë, por nuk e lëshojnë golashënuesin e tyre pa 15 milionë euro, kjo është shifra që vlerësojnë kartonin e tij. Sigurisht, kjo nuk është një shifër modeste për një klub si Lazio, por vlera e tij mund të rritet më shumë në rast se Manaj lë shenjë edhe në "Euro2024".

Gosens pas mbetjes jashtë 'Euro 2024': Kemi qarë së bashku me gruan

Robin Gosens ka pasur një sezon shumë të mirë, por nuk i ka mjaftuar të marrë ftesë për "Euro 2024". Mbrojtësi i majtë gjerman shkëlqeu me Union Berlinin, derisa në 37 ndeshje zyrtare realizoi edhe shtatë gola dhe

dhuroi katër asistime. Megjithatë trajneri i Gjermanisë, Julian Nagelsmann, nuk e mori për në "Euro 2024", pasi para tij u grumbulluan David Raum i RB Leipzig dhe Maximilian Mittelstadt i Stuttgart. Gosens ka

dhënë një deklaratë shpërthyesë duke zbuluar edhe bisedën me trajnerin Nagelsmann. Anësori ka thënë se shpërtheu në lot së bashku me gruan e tij pasi donte me çdo kusht të ishte në Kampionatin Evropian. "U ndjeva

si m*t kur Nagelsmann më thirri dhe më tha: 'Robin, më vjen shumë keq, por nuk mund të të marr me vete. Të vlerësoj shumë, por sezoni i Unionit nuk po shkon në favorin tënd'. "Gjithçka bëra që të shkoj në Euro. Është ëndrra ime

e fëmijërisë, por tani më ka ikur. Qava pas telefonatës, pastaj thirra gruan time dhe qamë së bashku", ka thënë Gosens. 29-vjeçari deri më tani ka zhvilluar 20 ndeshje me Gjermaninë që nga viti 2020 dhe ka edhe dy gola të shënuara.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Lindi Dekor Group" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812060870 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Lindi Dekor Group" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812060870 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Lindi Dekor Group" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812060870 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Choco-Tech" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70681307 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Choco-Tech" D.O.O. Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70681307 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Choco-Tech" L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 70681307 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nehat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

